

UDHËZIM
Nr. 269, datë 1.7.2021

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË REGJISTRIMIT NË REGJISTRIN
KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE TË VITIT 2010, TË REFUGJATIT OSE TË
PERSONIT NËN MBROJTJE PLOTËSUESE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, të nenit 92, të ligjit nr. 10/2021, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21, 33 dhe 59 të ligjit nr. 10129, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010, të refugjatit ose të personit nën mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë.

2. Të dhënat e refugjatit ose të personit nën mbrojtje plotësuese që i është miratuar leja e qëndrimit, importohen elektronikisht nga Regjistri Elektronik për të Huajt (FER) në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC).

3. Refugjati ose personi nën mbrojtje plotësuese paraqitet për regjistrimin e vendbanimit pranë zyrës së gjendjes civile në bashkinë/njësinë administrative në juridiksionin e së cilës ndodhet ndërtesa. Nëpunësi i gjendjes civile, pasi verifikon përputhshmërinë e të dhënave të dokumenteve të paraqitura, kryen regjistrimin e vendbanimit, duke aktivizuar më pas të dhënat e gjeneruara automatikisht nga ndërlidhja e sistemit FER në RKGJC.

4. Refugjatit ose personit nën mbrojtje plotësuese, të cilit leja e qëndrimit i lëshohet për herë të parë, duhet që brenda 30 ditëve nga dita e tërheqjes së dokumentit të lejes së qëndrimi, të regjistrojë vendbanimin pranë zyrës së gjendjes civile në bashki/njësi administrative përkatëse, duke paraqitur:

- a) kërkesën me shkrim dhe lejen e qëndrimit;
- b) dokumentin e pronësisë së banesës ose kontratë qiramarrjeje/huadhënie/përdorimi apo banimi; kontratën apo çdo dokument tjetër të ligjshëm, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, që i jep personit të drejtën e përdorimit të banesës; ose vërtetimin e vendbanimit të lëshuar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, nëse personi është me qëndrim pranë Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkues.

5. Për ndryshimin e vendbanimit të refugjatit ose të personit nën mbrojtje plotësuese, zbatohet legjislacioni në fuqi për gjendjen civile.

6. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, sa herë që e çmon të nevojshme, kërkon nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, informacionin e plotë për refugjatin ose personin nën mbrojtje plotësuese të regjistruar në RKGJC.

7. Me marrjen e informacionit për ndryshime në përbërësit e gjendjes civile për refugjatin ose personin nën mbrojtje plotësuese, autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët, njofton Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile ndjek këtë veprimtari me zyrat respektive të gjendjes civile në bashki/njësi administrative në vlerësimin e dokumentacionit dhe përcjelljen e akteve të nevojshme shkresore për përditësimin e të dhënave në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Autoriteti Përgjegjës për Azilin dhe Refugjatët dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

9. Urdhri nr. 28, datë 16.1.2017, “Për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të shtetasve të huaj që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Bledar Çuçi